



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.7.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Glogocit në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga, Evetar Zeqiri (Udhëheqës Ekipi), dhe Edon Kabashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	8
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	10
3 Rekomandimet e vitit paraprak	15
4 Qeverisja	16
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	31
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	34
Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it.....	39


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Glogocit për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 24.11.2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Komuna kishte klasifikuar gabimisht shpenzime në shumën 131,107€ ku nga kategoria e Investimeve Kapitale kishte paguar për Mallra & Shërbime dhe Subvencione & Transfere. Investimet Kapitale dhe Mallrat & Shërbimet janë mbi vlerësuar ndërsa Subvencionet & Transferet janë nënvlerësuar për shumën e shpenzimeve të keq klasifikuara;

Buxheti final tek neni 13, dalja e parasë gatshme ishte prezantuar gabimisht për 59,394€ më shumë sesa shifra e saktë. Ishte prezantuar 12,508,000€ ndërsa duhet të jetë 12,448,606€; dhe

Pagesat nga palët e treta ishin jo të plota. Një shumë prej 30,000€ e financuar nga UNDP dhe kompania Ferronikeli ishte lënë jashtë PVF-ve.


Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të përmendim faktin se Regjistri i shpalosur i Pasurive ende nuk është plotësisht i besueshëm sepse është i nën vlerësuar për të paktën 180,309€.


(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:







Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Menaxhmenti i Komunës. Përgjigjet e Menaxhmentit lidhur me çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar janë dhënë në detaje në Aneksin III.

Ne e marrim si punë të kryer faktin që Kryetari :

- Të diskutoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit Janar/shkurt 2016 të inicoj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të Komunës së Glllogocit të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shpreh opinionin:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e ndërmjetme të auditimit, ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i Komunës (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Edhe pse janë korrigjuar disa shifra në PVF, kanë mbetur gabime materiale që kanë të bëjnë me klasifikim të gabueshëm të shpenzimeve si investime kapitale, me plotësinë e pasurive dhe pagesave nga palët e treta. Të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm ishin përmbushur plotësisht.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Komuna kishte klasifikuar gabimisht shpenzime në shumën 131,107€ ku nga kategoria e Investimeve Kapitale kishte paguar për Mallra & Shërbime dhe Subvencione & Transfere. Investimet Kapitale dhe Mallrat & Shërbimet janë mbi vlerësuar ndërsa Subvencionet & Transferet janë nënvlerësuar për shumën e shpenzimeve të keq klasifikuara;

Buxheti final tek neni 13, dalja e parasë gatshme ishte prezantuar gabimisht për 59,394€ më shumë sesa shifra e saktë. Ishte prezantuar 12,508,000€ ndërsa duhet të jetë 12,448,606€; dhe

Pagesat nga palët e treta ishin jo të plota. Një shumë prej 30,000€ e financuar nga UNDP dhe kompania Ferronikeli ishte lënë jashtë PVF-ve.

Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të përmendim faktin se Regjistri i shpalosur i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm sepse është i nën vlerësuar për të paktën 180,309€. **(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).**

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 24.11.2014, janë identifikuar dy rreziqe. Gjatë auditimit të ndërmjetëm ne kemi identifikuar edhe një rrezik të keq-klasifikimit material të shpenzimeve. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit.

Të gjitha rreziqet e identifikua që kishin të bënin me plotësinë e pasurive, identifikimin dhe regjistrimin e pagesave nga palët e treta dhe klasifikimin e saktë të shpenzimeve kishin ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime të duhura për të adresuar rreziqet e paraqitura.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 - Regjistër jo i plotë dhe jo i besueshëm i pasurive në mungesë të regjistrimit të investimeve në vijim dhe mos përdorimit të modulit E-pasuria - Prioriteti i lartë

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive. Në memo të auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimet që nevojiten për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e saktë. Si rezultat, janë ndërmarrë një sërë veprimesh pozitive për regjistrimin e blerjeve të vitit 2014 dhe dokumentacioni në lidhje me to është përmirësuar. Shuma e pasurive të regjistruara në fund të vitit 2014 ishte 475,788,366€, krahasuar me vitin e paraprak, 16,704,063€, tregon një progres mjaft inkurajues. Për shkak të menaxhimit të dobët të pasurisë gjatë viteve, pjesa dërmuese e regjistrimeve i takonin viteve të më hershme. Kështu që konfirmimi i plotësinë së tyre ishte i vështirë për shkak të volumit të madh dhe evidencave jo të plota. Megjithatë, janë identifikuar dështime sistematike në menaxhimin dhe kontrollin e pasurive, siç janë: mos regjistrimi i plotë i pasurive, inventarizimi jo i plotë në fund të vitit, vlerësimi jo adekuat, dhe si rezultat i kësaj rreziku i identifikuar është materializuar, sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë kërkesat e mësipërme. Ne identifikuam se nuk ishin regjistruar 180,309€ pasuri mbi 1,000€ në regjistrat e pasurive në SIMFK. Po ashtu, Investimet në vijim nuk ishin regjistruar veçmas sipas pagesave, por në total pasi janë kompletuar projektet që ka ndikuar që ato të mos regjistrohen të gjitha. Përveç kësaj, ne nuk ishim në gjendje të konfirmonim shifrën e pasurive nën 1,000€ në PVF sepse nuk ishte përdorur moduli E-pasuria për regjistrimin e tyre.

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj vazhdimin e procesit të regjistrimit të të gjitha pasurive, ku rol kyç në këtë proces duhet të ketë Drejtoria e Kadastrit, duke siguruar/ofruar të gjitha të dhënat mbi pronat publike në posedim të komunës. Më pas, ne do të sugjerim që një komision i veçantë duhet të bëjë një vlerësim dhe një raport t'ia dorëzojë zyrtarit të pasurive për t'i proceduar regjistrimet e duhura në sistemin e SIMFK (moduli i pasurive). Gjithashtu, në fund të vitit duhet të kryhet inventarizimi i tërësishëm për të konfirmuar ekzistencën e pasurive (në veçanti të pasurive të luajtshme). Të funksionalizohet përdorimi i modulit E-Pasuria për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e pasurive nën 1,000€. Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen para se PVF-të e vitit 2015 të jenë dorëzuar.

Rreziku i identifikuar

Çështja 2 - Keq klasifikimi material i shpenzimeve të Mallrave dhe Shërbimeve dhe Subvencioneve si Investime Kapitale - Prioriteti i lartë

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Gjatë auditimit të ndërmjetëm ne kemi shqyrtuar kontrollet e menaxhmentit dhe proceset shoqëruese që janë zbatuar për rregullsinë e regjistrimit të shpenzimeve si dhe kemi dhënë këshilla për t'i përmirësuar ato. Megjithatë, auditimi ynë përfundimtar identifikoi keq klasifikime prej 131,107€, të cilat ishin paguar nga Investimet Kapitale për Mallra/Shërbime dhe Subvencione, shumë kjo materiale për PVF. Kjo ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk ka zbatuar kontrollet e duhura rreth planifikimit në nivelin e investimit kapital. Një rishikim i ynë i projekteve për investime publike të vitit 2015 ka treguar se një gjendje e njëjtë pritet të përsëritet edhe këtë vit.

Rekomandimi 2 Për vitin 2015 Kryetari duhet të sigurojë se planifikimet buxhetore do të përmirësohen dhe të gjitha shpenzimet do të bëhen në pajtim me ndarjet fillestare të buxhetit, duke eliminuar mundësinë e përdorimit të fondeve nga një kategori për qëllime të një kategorie tjetër pa aprovimet e duhura.

Rreziku i identifikuar

Çështja 3 - Mungesa e proceseve formale të identifikimit dhe raportimit të Pagesave nga Palët e Treta në PVF - Prioriteti i lartë

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne kemi rishikuar veprimet e ndërmarra nga Menaxhmenti për të identifikuar të gjitha pagesat e mundshme nga palët e treta. Kemi diskutuar me stafin kyç nëse ekzistonin procese formale që ofrojnë informacion se një pagesë nga palët e treta ka ndodhur. Po ashtu, kemi përdorur edhe informacionet nga burime të pavarura dhe i kemi verifikuar nëse janë regjistruar dhe prezantuar saktë dhe drejtë në PVF. Rreziku i identifikuar ka ndodhur sepse procesi aktual nuk ka siguruar plotësinë e tyre. Një pagesë prej 30,000€ për projektin e Ndriçimit Publik Solar nga UNDP dhe

kompania Ferronikeli ishte lënë jashtë PVF edhe pse komuna ishte e informuar për këtë projekt. E njëjta ishte prezantuar në PNF nëntë mujore të vitit 2014. Kjo ka ndodhur si rezultat i procesit të dobët të koordinimit të brendshëm dhe rishikimit joefektiv të PVF finale.

Rekomandimi 3 Procesi i identifikimit të pagesave nga palët e treta do duhej të ishte i thjeshtë dhe i lehtë sepse komuna i njeh përfituesit dhe financuesit e pagesave. Kryetari duhet të siguroj se para se PVF të hartohen konfirmimi i këtyre pagesave bëhet prej përfituesve. Në rast se nuk ka informacione nga përfituesit, atëherë mund të shfrytëzohen informacionet nga donatorët. Për të mbështetur këtë proces, nevojitet një koordinim më i mirë i brendshëm.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Komuna duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore duke përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore;
- Raportet operative (të performancës); dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit.

Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, e datës 15.12.2014, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti, me përjashtim të çështjes që PVF nuk ishin përgatitur edhe në gjuhën serbe dhe se raporti vjetor financiar i dërguar në kuvend përmbante disa pasaktësi sa i përket buxhetit final. Nevoja për ta adresuar këtë situatë është e reflektuar në memorandumit tonë të veçantë për stafin financiar.

Megjithëse PVF fillestare ishin korrigjuar, PVF përfundimtare edhe me tutje përmbajnë disa gabime materiale.

Çështja 4 - Mangësi dhe keq prezantim i informatave në PVF - Prioritet i lartë

E gjetura	Për shkak të procesit joefektiv të rishikimit nga Menaxhmenti, të aplikuar në PVF: Neni 12 Pagesat nga palët e treta ishin prezantuar më pak për 30,000€ dhe nuk ishin shpalosur në brendi të PVF-ve; Buxheti final neni 13 – në pjesën e daljes së parasë së gatshme ishte prezantuar, gabimisht për 59,394€ më shumë. Buxheti i prezantuar ishte 12,508,000€ ndërsa duhet të jetë 12,448,606€. Këto gabime reflektohen edhe në nenin 18 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale; Shënimi 15 Të hyrat vetjake ishte shpalosur më shumë për 23,189€, sepse kjo vlerë është grant i donatorëve të brendshëm. Kjo ka ndikuar që edhe shënimi 36 Bilanci i të hyrave të pa shpenzuara për bartje në 2015 të prezantohet gabimisht për këtë shumë; Keq klasifikimi i shpenzimeve ishte 131,107€ ku nga kategoria investime kapitale ishin paguar mallra/shërbime dhe subvencione; Ishte bërë një pagesë e parregullt prej 16,370€ nga kategoria investime kapitale sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit në mungesë të dëshmive. Për më tepër referoju kapitullit 4.4.2; Obligimet e pa paguara ndaj punonjësve të arsimit (36,580€) ishin lënë jashtë PVF, ndërsa detyrimet kontingjente ishin prezantuar vetëm 33,485€, ndërsa vlerësohet të jenë 584,410€; dhe Marrë parasysh më lart, Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri konsiderohet jo e plotë dhe e pa saktë
Rreziku	Nuk është e qartë nëse zyrtarët përgjegjës për hartimin e pasqyrave i kuptojnë drejt kërkesat dhe rëndësinë e raportimit të saktë të gjendjes financiare të komunës. PVF-të që nuk i nënshtrohen një rishikimi të nivelit të duhur të Menaxhmentit, potencialisht mund të kenë gabime materiale të cilat kanë ndikuar në opinion të kualifikuar.
Rekomandimi 4	Kryetari duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF 2015 të përfshijë rishikimin në hollësi të draft PVF-ve nga Menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse në të gjitha draft PVF-të janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme duke përfshirë këtu edhe një rishikim të dytë të pavarur të punës së ZKF-së. Për të shmangur përsëritjen e gabimeve në të ardhmen, kryetari duhet të inicioj që të ndiqen trajnimet/udhëzimet e Thesarit që organizohen çdo fund vit lidhur me hartimin e PVF-ve.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Edhe pse rekomandimet e më hershme të auditimit janë shqyrtuar, shumica prej tyre duhet të zbatohen plotësisht.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit të Komunës për PVF-të e vitit 2013 të ka rezultuar në 20 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve. Plani i veprimit ishte dobët i përgatitur sepse nuk paraqitej mënyra dhe stafi përgjegjës se si do të adresoheshin të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, gjashtë (6) rekomandime ishin adresuar plotësisht, pesë (5) ishin adresuar pjesërisht dhe nëntë (9) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Çështja 5 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Rekomandimet e vitit të kaluar janë zbatuar vetëm pjesërisht sepse komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces efektiv për ta menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP. Kjo edhe si rezultat që plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve vetëm formalisht ishte përgatitur dhe nuk përcaktonte veprimet, stafin përgjegjës dhe kohën për adresimin e rekomandimeve.

Rreziku Mos adresimi i dobësive të vazhdueshme të kontrolleve të Menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe kanë rezultuar në:

- Regjistër jo të plotë të pasurive, keq-klasifikim të shpenzimeve, dhe prezantim jo të plotë të pagesave nga palët e treta në PVF;
- Nivel të ulët të mbledhjes së të hyrave dhe rritje e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme; dhe
- Jo-efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe vlerë të dobët për para nga procesi i prokurimit;

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të forcoj masat e llogaridhënies lidhur me adresimin e plotë rekomandimeve. Një plan veprimi, i rishikuar, duhet të përcaktojë saktë afatet kohore, aktivitetet specifike dhe stafin përgjegjës për adresimin sipas prioriteteve të rekomandimeve të bëra nga AP, fillimisht në fushat më të rëndësishme, si dhe ky raport të diskutohet në kuvend komunal.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes që mund të adresohen nga Komuna janë si në vazhdim:

- Vetëvlerësimi - edhe pse ishte pranuar dokumenti i vetëvlerësimit, Komuna nuk e ka kryer vetëvlerësimin që do t'i shërbente si pikënisje për të përmirësuar performancën e saj aty ku shihet e nevojshme. Kjo si rezultat i neglizhencës ndaj kërkesës për vetëvlerësim;
- Menaxhimi i rrezikut - komuna ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës, që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërliken me arritjen objektivave të komunës;
- Raportim efektiv ndaj menaxhmentit i cili duhet të jetë më i formalizuar; dhe
- Auditimi i brendshëm – duhet të maksimizohet puna e sistemit të auditimit të brendshëm dhe të forcohet bashkëpunimi ndërmjet kryetarit me Auditorin e Brendshëm dhe Komitetin e Auditimit. Aty ku kërkohet rishikim i brendshëm më kritik për të siguruar që është arritur më shumë ndikim nga raportet e AB-së.

Si të tilla, aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes kërkojnë forcim. Po ashtu, ne kemi identifikuar që kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtijshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projekteve kapitale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: prokurimi, planifikimi dhe realizimi i buxhetit, monitorimi efektiv i subvencioneve dhe pagesave me bashkëfinancim. Megjithatë, komuna e ka adresuar në mënyrë aktive reduktimin e buxhetit për 15% që ka të bëjë me mallrat dhe shërbimet dhe raporti i auditimit të jashtëm nga viti i kaluar është diskutuar në asamblenë komunale.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Qeverisja ka të bëj me sistemin me të cilin organizatat menaxhohen dhe kontrollohen. Një qeverisje efektive kërkon planifikim të fortë, aranzhime të monitorimit dhe raportimit të cilat adresojnë rreziqe operative dhe strategjike më të cilat ballafaqohet një organizatë.

Rekomandimi

Çështja 6 - Aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes – Prioriteti i lartë

E gjetura	Disa aspekte të qeverisjes së mirë nuk kanë funksionuar në Komunë. • Mbështetja në komunikim joformal ka çuar në një raportim i cili nuk e demonstroi shqyrtimin e sfidave kyçe operative dhe përgjigjen ndaj këtyre. Kjo është edhe arsyeja pse ne nuk jemi mbështetur në kontrollet e raportimit të Menaxhmentit (si pjesë e qasjes sonë të auditimit); • Mos zhvillimi i aranzhimeve të komunikimit efektiv në Komunë ka rezultuar në koordinim të dobët dhe aranzhime të dobëta të kontrolleve në fushat si menaxhimi i pasurive dhe pagesave nga palët e treta; dhe • Kërkesat për të aplikuar vetëvlerësimin dhe hartimin e regjistrit të rreziqeve janë adresuar vetëm pjesërisht, pasi rëndësia e këtyre si mjete për ta mbështetur menaxhimin efektiv nuk përdoret gjithaq nga Komuna. Nuk ka të vendosur regjister formal të rrezikut apo procese të menaxhimit të rrezikut dhe vetëvlerësimi nuk është bërë në një nivel të mjaftueshëm të rishikimit.
Rreziku	Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi i cilësisë së dobët, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit operativ dhe financiar brenda komunës dhe potencialisht mund të rezultojnë me humbje financiare.
Rekomandimi 6	Kryetari duhet të siguroj se do bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të qeverisjes/llogaridhënies dhe të kërkesave shoqëruese të raportimit në Komunë. Veprime duhet të ndërmerren për të siguruar të siguruar një menaxhim efektiv operativ të Komunës dhe arritjen e objektivave strategjike.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	10,982,419	12,448,606	11,356,778	9,669,639	9,924,283
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,932,419	10,939,812	10,199,369	8,564,382	9,008,224
Të bartura nga viti paraprak ²	0	131,513	122,701	382,455	285,496
Të hyrat vetjake ³	1,050,000	1,353,557	1,011,884	710,067	611,793
Donacionet e brendshme	0	23,724	22,824	12,735	0
Donacionet e jashtme	0	0	0	0	18,770

Buxheti final është për 1,466,187€ më i lartë se buxheti fillestar. Kjo rritje, kryesisht është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, një rritjeje të planit të të hyrave të njehershme nga kuvendi komunal dhe rritjeve të buxhetit në harmoni me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2014, komuna ka shfrytëzuar 91% të buxhetit final ose 11,356,778€, një nivel më i ulët për 5% krahasuar me vitin 2013 (96%). Realizimi i buxhetit në nivel të kategorive mallra dhe shërbime dhe investime kapitale është jo i kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2.Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike-realizimi ndaj buxhetit(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	10,982,419	12,448,606	11,356,778	9,669,639	9,924,283
Pagat dhe Mëditjet	6,066,625	7,087,802	7,047,865	6,040,187	6,014,799
Mallrat dhe Shërbimet	976,092	1,119,073	944,456	848,588	794,448
Shërbimet komunale	197,893	230,839	205,915	145,183	172,474
Subvencionet dhe Transferet	335,000	360,157	347,334	181,343	169,784
Investimet Kapitale	3,406,809	3,650,735	2,811,208	2,454,338	2,772,778

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat vetjake komunale të planifikuara dhe të shpenzuara.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes në buxhetin për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 77% e buxhetit ishte shpenzuar. Buxheti për investime kapitale ishte rritur edhe me një vendim të asamblesë komunale në fund të vitit 2014. Niveli i ulët i ekzekutimit ndërlidhet kryesisht me jo efikasitet në departamentin e prokurimit si: vonesa në përmbushjen e planit të prokurimit, numrin e madh të procedurave me kuotim dhe vlera minimale, mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe planifikimit të dobët të paramasave dhe parallogarive për projektet kapitale që kanë shkaktuar vonesa të ndryshme;
- Ekzekutimi i buxhetit për mallra dhe shërbime ishte vetëm 84%. Përkundër që buxheti ishte i nën shpenzuar në fund vit, komuna kishte ndarë buxhet shtesë me një rishikim të planit të të hyrave prej 49,153€. Kjo është në drejtim të kundërt me kërkesat e Qeverisë për shkurtime buxhetore në Mallra dhe Shërbime. Megjithatë, duke e pasur parasysh mos alokimin e 15% të buxhetit, shkalla e vërtetë e ekzekutimit është 94%. Edhe këtu arsyet e ekzekutimit të ulët ndërlidhen me mos alokimin e 15% nga Qeveria dhe mos alokimin e buxhetit shtesë nga të hyrat e shpronësimit si rezultat i procedimit të vonshëm të buxhetit tek Ministria e Financave në fund të vitit 2014.
- Buxheti final për paga është afërsisht 17% më i lartë se ai fillestar, kjo për të mbuluar ngritjen e pagave për 25% të zbatuar në prill 2014, gjë që nuk është reflektuar në buxhetin fillestar. Realizimi i buxhetit të pagave dhe mëditjeve në vitin 2014 është 99%.

Rekomandimi

Çështja 7 - Shpenzimet përmes vendimeve gjyqësore dhe Nenit 39.2 të LMFFP - Prioriteti i lartë

E gjetura	Për shkak se komuna nuk i kishte kryer pagesat me kohë, bazuar në legjislacionin ekzistues, sipas vendimeve gjyqësore, nga Thesarit ishin ekzekutuar 139,639€, kryesisht për shkak të mos pagesës së punonjësve të arsimit, ndërsa si pagesa direkt nga neni 39.2 i LMFFP-së ishin 188,239€. Për pagesat për punonjës të kryera nga Thesari, evidenca të duhura duhet të mbahen nga komuna për të evituar rrezikun e pagesave të dyfishta.
Rreziku	Shumat e ekzekutuara të pagesave në bazë të vendimeve gjyqësore ndikojnë në prishjen e bilancit buxhetor dhe rrisin rrezikun që projektet e planifikuara të mos realizohen dhe të zvogëlohet fleksibiliteti në shpenzimet e komunës.
Rekomandimi 7	Kryetari duhet të siguroj se do të bëj një planifikim të mirëfillt të buxhetit; forcojë një disiplinë financiare për kryerjen e pagesave me kohë si dhe do t'i rishikoj të gjitha obligimet e pa paguara në mënyrë që të evitohet vonesat në kryerjen e pagesave.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Komunës – ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetanake	1,050,000	1,353,557	1,412,710 ⁴	841,160	868,358

Plani i të hyrave për 2014 ishte realizuar 104% me një rritje prej 20% krahasuar me realizimin e planit të vitit 2013 (84%). Kjo rritje sinjifikante kryesisht është si rezultat i të hyrave nga eksproprijimi i tokës komunale nga Qeveria për ndërtimin e autostradës, në shumë 399,000€ të cilat nuk ishin planifikuar në buxhetin fillestar. Po ashtu, edhe tejkalimi realizimit të planit mbi 100% tek disa kategori të të hyrave si tatimi në pronë, qiraja e objekteve, gjobat e gjykatave dhe dënimet në trafik. Përkundër kësaj, një suficit kumulativ prej 409,638€ i të hyrave vetjake nga viti 2014 dhe vitet më hershme, ka mbetur për tu bartur në vitin 2015.

Rekomandimi

Çështja 8 – Planifikim i dobët dhe realizim i ulët i buxhetit – Prioriteti i mesëm

E gjetura Edhe pse Komuna i ka bërë disa ndryshime buxhetore gjatë vitit 2014, kërkesat e përgjithshme të buxhetit për shpenzime nuk janë përcaktuar në mënyrë adekuate dhe ngjashëm projeksionet e të hyrave janë joreale. Komuna kishte propozuar një rritje të buxhetit për paga dhe mëditje për 49,153€ në fund të vitit bazuar në të hyra vetjake nga eksproprijimi i tokës komunale, të cilat nuk lejohet të shfrytëzohen për paga dhe mëditje, dhe kjo nuk ishte aprovuar as nga Ministria e Financave.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët i buxhetit do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe shtyrjen e detyrimeve të vitit aktual tek buxheti i vitit të ardhshëm, duke e reduktuar mundësinë për t'i arritur objektivat e ardhme të komunës. Kjo, po ashtu, demonstrohet edhe nga niveli i suficitit domethënës i të hyrave vetjake që do të barten në vitin 2015.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të siguroj monitorim sistematik të performancës buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të përmirësuar nivelin e realizimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, këto duhet të rishikohet në buxhetin final.

⁴ Kjo shumë përfshinë edhe 113,723€ të hyrat nga dënimet e trafikut; 46,555€ të hyrat nga dënimet e gjykatave dhe 1,569€ të hyrat nga Licencat e pyjeve.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga komuna gjatë vitit 2014 në total ishin 1,412,710€. Këto kishin të bëjnë kryesisht me tatimin në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiratë dhe të hyrat nga taksa administrative. Edhe pse niveli i arkëtimit tek të hyrat nga qiratë është rritur krahasuar me vitin e kaluar, ende shfrytëzuesit e pronave me qira nuk paguajnë rregullisht obligimet e tyre. Nevojiten veprime pro aktive për të rritur nivelin e inkasimit në fusha tjera, siç janë tatimi në pronë, duke rritur kapacitet e brendshme njerëzore për të përmbushur planin e të hyrave.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë që fondet publike aplikohen në mënyrë transparente dhe eficiente për të arritur vlerën për paranë. Korniza ligjore qartazi definon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë palëve të përfshira në prokurimin publik. Kjo përfshinë kërkesat për të zbutur rreziqet sa i përket vonesave në kryerjes së punëve, shmangien e konfliktit të interesave, ofertave jo të plota dhe arritjen e vlerës për para.

Gjithsej 229 procedura të prokurimit ishin zbatuar në vitin 2014, përfshirë edhe ato të anuluarat (vlera 3,226,002€), prej të cilave 9 (nëntë) raste të prokurimit në shumë prej 111,893 nuk janë planifikuar në planin e prokurimit.

Rekomandimet

Çështja 9 – Menaxhim dhe kontroll i dobët për shpenzimet e naftës për ngrohje –Prioriteti i lartë

- E gjetura** Si rezultat i menaxhimit të dobët të kontratës, janë aplikuar çmime të gabuara (më të larta) për furnizimet me naftë për ngrohje. Ne kemi identifikuar 3 furnizime me naftë për ngrohje në sasi 12,889 litra që ishin paguar 1,224€ më shumë, sepse kompania e derivateve kishte zbatuar çmimin gabimisht. Furnizimet e lartcekura ishin bërë në dhjetor 2014, ndërsa ishin faturuar me çmim të nëntorit që ishte më i lartë sesa çmimi i dhjetorit. Kontrata parasheh që për furnizimet e muajit paraprak, fatura dërgohet në komunë në javën e parë të muajit pasues.
- Rreziku** Zbatimi i dobët i kontrolleve ndaj shpenzimeve mund të rezultojë me pagesa më të larta dhe humbje direkte financiare për komunën.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të shqyrtojë arsyet pse janë zbatuar kontrolle të dobëta në menaxhimin e kontratave dhe të analizoj arsyet për pagesa më të larta. Gabimet në shpenzimet e paguara më shumë, duhet të korrigjohen me operatorin dhe raste të tilla duhet eliminohen në të ardhmen.

Çështja 10 – Dobësi sistematike në prokurim – Prioritet i lartë

Shqyrtimi i 19 kontratave ka identifikuar një sërë dobësish të përbashkëta.

Procedurat me kuotim çmimesh ishin përdorur në masë të madhe për mallra ose shërbime të natyrës së njëjte. Mbi 56 procedura ishin zhvilluar që ka shkaktuar jo-efikasitet dhe vonesa të ndryshme. Vetëm për furnizime me pajisje të Teknologjisë Informative, ishin zhvilluar mbi 10 procedura të prokurimit. Kjo si rezultat i mos koordinimit ndërmjet departamenteve dhe mos agregimit të kërkesave. Ngjashëm në disa raste ishte vepruar edhe për investime kapitale, ndonëse më pak e shprehur.

Më tej, sigurimi i ekzekutimit të kontratës nuk ishte sipas kërkesave të komunës. Në katër raste siguria e ekzekutimit e ofruar nga operatorët ishte më e vogël se 10%. Po ashtu këto sigurimi nuk e mbulonin periudhën e kontratave sepse kishin vlefshmëri më të shkurtër. Rastet e përmendura më lartë janë: Rregullimi i Infrastrukturës në Lagjen e Dëshmorëve; Ndërtimi i Ujësjellësit në fshatin Baicë, Lot 1; Ndërtimi i stadiumit, dhe Furnizimi me naftë për automjete komunale.

Këta shembuj reflektojnë kuptim dhe zbatim të dobët të kërkesave të prokurimit nga Komuna.

Vlerësim i dobët i nevojave

9 prokurime prej 111,893€ nuk janë përfshirë në planin e prokurimit fillestar të dërguar te Agjencia Qendrore e Prokurimit, për shkak të planifikimit joadekuat dhe dallimit në mes të prokurimeve fillestare të planifikuara dhe nevojave.

Rreziku

Mos ndjekja e procedurave të duhura të prokurimit mund të rezultojë në vlerë të dobët për para dhe humbje financiare nga prokurimi si rezultat i zbatimit të dobët të rregulloreve. Ndarja e tenderëve për blerje të artikujve të njëjtë, rrit rrezikun që të shmanget konkurrenca dhe blerjet të bëhen me çmime më të larta.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të inicioj një analizë të plotë pse janë aplikuar praktika të dobëta të prokurimit në këto raste dhe të zbatojë kontrole të shtuara të cilat sigurojnë se: prokurimet i reflektojnë nevojat; specifikacionet e tenderit i reflektojnë kërkesat aktuale; dhe furnizimet i reflektojnë kërkesat e drejtorive. Në përgjithësi, kontrollet e prokurimit duhet që dukshëm të forcohen.

Çështja 11 – Dobësi jo sistematike të prokurimit – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Kriteri i pa specifikuar qartë dhe diskriminues, për kontratën Furnizim me material stomatologjik Lot 1. Kriteri i vendosur për ofrimin e një raporti financiar për tri vitet e fundit (2013, 2012, dhe 2011) kishte ndikuar që operatori më i lirë – me çmim 4,445€/njësi – në këtë procedurë të eliminohej sepse kjo kompani ishte themeluar në fillim të vitit 2014 dhe rrjedhimisht nuk posedonte raport për tri vitet e më hershme. Kontrata i ishte dhënë një ofertuesi tjetër me çmim më të shtrenjtë për 150€ për njësi (4,595€).
- Rreziku** Kërkesat e tenderit që janë diskriminuese ose minojnë konkurrencën nuk janë në pajtim me parimet kyçe të prokurimit publik. Po ashtu, ato mund të rezultojnë me humbje të financiare për komunën.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe të zbatojë kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë e identifikuara janë adresuar.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Shpenzimet jo përmes prokurimit janë shpenzimet për të cilat nuk aplikohen procedurat e prokurimit. Ato kanë të bëjnë me komunalit, shpenzimet e udhëtimit dhe pagesat me bashkëfinancim.

Rekomandimet

Çështja 12 – Kontrole të dobëta për shpenzimet e ujit për shkollat fillore dhe të mesme – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Si rezultat i kontroleve të dobëta të zbatuara ndaj shpenzimeve për ujë në një numër shkollash fillore dhe të mesme kanë rezultuar shpenzime enorme për ujë. Sipas një shkrese të datës 19 nëntor 2014 drejtuar komunës nga kompania e furnizuese, ishte njoftuar për një obligim prej 22,133€ të pa paguar. Më së shumti borxhe kishte shkolla “Fehmi Lladrovci” që arrinin 9,990€. Vizita jonë në këtë shkollë ka identifikuar se për faturat e ujit dhe shpenzimet tjera komunale nuk zbatohen kontrole adekuate. Shpenzimet mesatare për këtë shkollë silleshin prej 300-350€ ndërsa gjatë vitit 2014 ato arrinin deri 1,370€. Sipas zyrtarëve të shkollës kjo ka ndodhur si pasojë e një rrjedhjeje në gypat kryesor dhe mos intervenimit me kohë. Përkundër që shkolla nuk ishte pajtuar me ato shpenzime dhe ankesave për verifikim të gjendjes nga kompania, asnjë veprim tjetër nuk ishte ndërmarrë dhe ato fatura ishin paguar.

Rreziku Zbatimi i dobët i kontrolleve ndaj shpenzimeve si mungesa e proceseve formale të verifikimit të faturave dhe reagimi i vonshëm apo neglizhenca e problemeve mund të rezultojë me pagesa më të larta, rrjedhimisht humbje financiare për komunën.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të inicioj një shqyrtimin të plotë të arsyeve pse janë zbatuar kontrolle të dobëta ndaj shpenzimeve dhe të sigurojë vendosjen e proceseve formale të verifikimit të faturave. Shqyrtimi duhet të përfshij krahasimin e faturave me sasitë e ujit të harxhuar, dhe aty ku vërehen devijime të mëdha, ato duhet të hetohen dhe të qartësohen.

Çështja 13 – Pagesa bazuar vetëm në marrëveshje të mirëkuptimit në mungesë të dëshmive adekuate - Prioriteti i lartë

E gjetura Në vitin 2014, një pagesë prej 16,370€ ishte bërë bazuar në një marrëveshje për bashkëfinancim me OJQ “International Relief and Development (IRD) ” dhe kompanisë publike “KUR Prishtina” për vendosjen e një filtri shtesë në fabrikën për prodhimin e ujit në komunën e Glllogocit. Kjo marrëveshje ishte monitoruar dobët. Në total marrëveshja arrinte 83,270€, ku nga komuna parashihej pjesëmarrja 43,270€, ndërsa pjesa tjetër, nga bashkë financuesit tjerë.

Rreziku Si rezultat i procedurave të dobëta raportimit dhe të kontrollit, kostot e paguara nga Komuna mund të jenë më të mëdha se sa është e nevojshme dhe mundet që objektivat e shpenzimeve të mos arrihen. Asnjë mekanizim nuk ka që ofron vlerë për paranë.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet t’i rishikojë të gjitha marrëveshjet ekzistuese për bashkëfinancim duke analizuar racionalitetin për pagesat si para dhënie – pagesat në kohën e nënshkrimit të marrëveshjeve. Përveç kësaj, marrëveshjet e bashkëfinancimit duhet të azhurnohen për formuar një bazë për raportim të rezultateve të implementimit të projekteve dhe monitorim efektiv. Raportet finale duhet të bëhen publike për të siguruar transparencë në/dhe llogaridhënie për mënyrën e shpenzimit të parasë publike.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhën përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollët kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave si aprovimi dhe futja në listë të pagave të punonjësve të rinj, verifikimi i numrit të lejuar të operuara dhe kontrollët tjerë shoqërues nga Ministria e Administratës Publike. Aprovimi i buxhetit për paga dhe mëditje bëhet nga asambleja komunale e aprovimi i shtesave apo ndryshimeve të nevojshme dhe nënshkrimi i listave të pagave nga menaxheret përkatës që operohen nga komuna.

Rekomandimi

Çështja 14 – Angazhimi i punonjësve të arsimit jashtë planifikimit buxhetor dhe listës së pagave – Prioriteti i mesëm

E gjetura Të shtyrë nga nevoja për të zëvendësuar punonjëset në pushim të lehonisë dhe apo llojeve tjera të pushimeve, komuna gjatë vitit 2014 kishte angazhuar 19 punonjës si zëvendësues për të cilët nuk kishte buxhet të lejuar. Si rezultat nuk arrinte t'i fuste në listë të pagave. Ky fenomen ishte trashëguar edhe nga vitet e më hershme me një numër të ngjashëm dhe vazhdon të ndodhë edhe në vitin 2015. Këtyre punonjësve komuna u kishte mbetur obligime financiare në pamundësi t'i paguaj pagat. Punonjësit kanë bërë padi gjyqësore ndaj komunës dhe kërkesa për ekzekutim direkt nga Thesari të pagave të tyre, bazuar në nenin 39.2 të LMFP-së. Për vitet 2013/2014, mbi 72 pagesa të tilla janë kryer nga thesari dhe gjykata.

Gjatë vitit 2014 ishte themeluar një komision për shqyrtimin e ankesave nga punonjësit i cili kishte aprovuar 116 ankesa. Prej tyre pagesat ishin kryer për 72 ankesa, ndërsa pjesa tjetër është bartur për tu paguar në vitin 2015.

Rreziku Angazhimi i stafit në mungesë të buxhetit rrjedhimisht mos futja në listë të pagave, kanë rezultuar në padi gjyqësore dhe ekzekutime direkte nga Thesari dhe kanë shkaktuar implikime buxhetore për komunën duke reduktuar fleksibilitetin e shpenzimeve.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të siguroj që kjo çështje të ngritët edhe në nivel të asociacionit të komunave në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme për këtë problem. Përveç kësaj, nevojitet një planifikim më i mirë i stafit gjatë procesit buxhetor.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Subvencionet kryesisht u ndahen entiteteve publike dhe jo publike dhe personave fizik në nevojë. Kontrollat operuese nga komuna përcaktohen me rregulloren e brendshme dhe udhëzimet e përgjithshme të shpenzimit të parasë publike. Vendimet për subvencione aprovohen nga kryetari deri në shumën 1,500€ ndërsa mbi këtë nga asambleja komunale bazuar në rregulloren e brendshme.

Rekomandimi

Çështja 15 - Monitorim i dobët dhe mungesa e raportimeve financiare kthyesë - Prioritet i mesëm

E gjetura Rezultati/ndikimi i subvencioneve jo gjithmonë ishin monitoruar dhe raportuar tek Menaxhmenti. Në tri (3) nga pesë rastet e shqyrtuara, raportet narrative financiare të përfituesve nuk mbështeteshin nga dëshmitë relevante. Asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë për të siguruar këto raporte. Këto ishin për Klubin “Drenica” në shumë 5,000€ dhe një përfitues individual në shumë 1,500€. Për subvencionimin e klubit futbollistik “Ferronikeli” në shumë 20,000€, nuk kishte dëshmi të duhura se si ishin paguar pagat për lojtarët, sepse pagesat nga klubi ishin bërë në para të gatshme, e jo përmes llogarisë bankare të klubit.

Rreziku Dështimi për të nxjerrë informata adekuate të monitorimit mund të rezultojë në mosarritjen e objektivave të subvencioneve dhe rrit rrezikun për pagesa të parregullta. Mungesa e dëshmive adekuate që mbështesin shpenzimet, rrisin rrezikun që pagesat të mos kryhen ashtu siç deklarohen.

Rekomandimi 15 Kryetari të sigurojë se të gjitha subvencionet janë subjekt i monitorimit efektiv bazuar në kërkesa qartë të përcaktuara për raportim për mënyrën e shfrytëzimit të subvencioneve. Aty ku kërkesat nuk respektohen, masa adekuate duhet të ndermirren, si suspendimi i pagesave.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat e validizojnë ekzistencën e pasurive ekzistuese dhe sigurojnë të dhëna të azhurnuara në pajtueshmëri me pasuritë e reja dhe ndryshimet tjera.

Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 2.2 Rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare.

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Llogaritë e Arkëtueshme janë detyrime në mjete financiare që të tjerët i kanë ndaj komunës. Në fund të vitit 2014 ato ishin 1,724,335€ një rritje prej 11.5% nga viti 2013. Këto kryesisht kanë të bëjnë me (a) tatimin në pronë 1,347,832€; (b) taksat komunale 279,010€; (c) qiraja 59,689€ dhe (d) lejet e ndërtimit 37,804€.

Rekomandimi

Çështja 16 – Nivel i lartë i Llogarive të Arkëtueshme dhe mungesa e strategjive dhe veprimeve efektive për mbledhjen e tyre – Prioritet i mesëm

E gjetura

Edhe pse të Arkëtueshmet ishin rritur nga vitet e mëhershme, komuna nuk ka hartuar ndonjë strategji praktike për mbledhjen e borxheve të saj, e as nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim domethënës për t'i nxitur pagesat. Përderisa niveli i arkëtimit tek tatimi në pronë dhe të hyrat nga qiraja qëndron relativisht mirë, tek pjesa tjetër, arkëtimi mbetet jo i kënaqshëm. Për shembull të hyrat e planifikuara për leje ndërtimit ishin realizuar vetëm 62% ndërsa ato për taksa komunale 84%.

Të hyrat nga lejet e ndërtimit të pa arkëtuara në vitet e më hershme janë 37,804€. Ato do duhej të arkëtoheshin të plota në momentin e lëshimit të lejes. Ato nuk ishin paguar të plota, pagesa ishte mundësuar me këste dhe kjo pjesë e mbetur për pagesë nuk është kryer ende. Veprime të nevojshme do duhej të ndërmerreshin për të inkasuar plotësisht ato gjatë vitit 2014 ose edhe më herët.

Rreziku Një qasje joefektive në mbledhjen e borxhit do të rezultojë me humbje financiare për Komunën; zvogëlon mundësitë e investimit nga burimet vetjake; dhe paraqet precedent të keq ku mos pagesat mund të bëhet normë.

Rekomandimi 16 Kryetari të siguroj një shqyrtim rigoroz të të arkëtueshmeve për të përcaktuar çka mund të mblidhet dhe të aplikojë masat ligjore për maksimizimin e niveleve të inkasimit. Veprime konkrete duhet të ndermirren përfshirë masat ligjore apo edhe revokimin e lejeve të objektit ndaj borxhlinjve.

4.5.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Komuna i ka zvogëluar obligimet e papaguara në mënyrë sinjifikante nga 264,470€ sa ishin në vitin 2013 në 36,037€ në fund të vitit 2014. Megjithatë, suficiti prej 409,638€ i të hyrave vetjake të pa shpenzuara në vitin 2014 që janë bartur në vitin 2015 ka demonstruar një jo-efikasitet në menaxhimin e plotë të borxheve.

Rekomandimi

Çështja 17 - Proces jo efektiv i raportimit të obligimeve - Prioriteti i lartë

E gjetura Procesi aktual i përdorur për raportimin e faturave të pa paguara është i dobët dhe nuk ofron siguri të se të gjitha faturat e pa paguara nga departamentet tjera përcillen me kohë tek Zyrtari Kryesor Financiar për tu pasqyruar në raportet mujore të obligimeve dhe PVF. Për shkak të kësaj, shpenzimet e ujit në shkolla nuk ishin raportuar me kohë, gjë që ilustron një proces jo efektiv të raportimit të obligimeve.

Obligimet financiare të mbetura për paga ndaj punonjësve të arsimit të cilat kanë rrjedhur si rezultat i mos futjes në listë të pagave gjatë viteve të më hershme (36,580€) nuk janë prezantuar në PVF. Kjo si rezultat i kuptimit të dobët të kërkesave të raportimit.

Rreziku Mbështetja në procese jo formale dhe të pa dokumentuara të raportimit të obligimeve financiare rrisin rrezikun që pozita financiare e komunës të keqkuptohet dhe që PVF të mos pasqyrojnë gjendjen reale. Po ashtu, ekziston rreziku që komuna të ketë implikime financiare në të ardhmen si rezultat i shfaqjes së pa pritur të obligimeve.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të sigurojë se aranzhimet duhet të jenë më pro aktive për të konsoliduar plotësinë e obligimeve duke mos lënë vetëm në vullnetin dhe/ose neglizhencën e zyrtarëve për të përcjellë faturat e pa paguara tek departamenti i financave. Procesi aktual duhet të rishikohet për të siguruar raportim efektiv të obligimeve.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij, ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga dy punonjës –drejtori dhe një zyrtar. Tetë auditime të planifikuara ishin kryer të gjitha me fokus kryesisht tek të hyrat komunale (tre auditime), pasuritë (dy auditime), dhe nga një në personel dhe procedura të prokurimit. Në planin strategjik shpenzimet bartnin rrezik të lartë, ndërsa ishte kryer vetëm një auditim. Kjo reflektohet edhe me mangësi në kontrolle dhe të gjetura në fushën e shpenzimeve të trajtuara më lartë në këtë raport. Puna e kryer ishte e një cilësie të mirë e mirëmbajtur dhe dokumentuar kënaqshëm.

Rekomandimi

Çështja 18 – Zbatim i dobët i rekomandimeve të NjAB dhe ndikimi i Komitetit të Auditimit – Prioritet i lartë

E gjetura Edhe pse Komiteti i Auditimit dhe Kryetari janë takuar katër (4) herë për t'i diskutuar raportet e Auditimit të Brendshëm, nuk u është dhënë rëndësi e duhur rekomandimeve dhe nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Prej 56 rekomandimeve gjatë 2014, vetëm 23 ishin adresuar plotësisht. Kjo ka reflektuar nga një mungesë e takimit të drejtorëve të drejtorive të audituara. Në këtë mënyrë, nuk ka ndikim të dukshëm të komitetit në adresimin e rekomandimeve apo përmirësimin e kontrolleve operative nga Komuna, për fushat ku janë dhënë rekomandimet.

Rreziku Dështimi për të adresuar rekomandimet rrit rrezikun që dobësitë e identifikuara nga auditimi i brendshëm të mbesin të pa përmirësuara që mund të rezultojë me jo efikasitet të vazhdueshëm organizativ, humbje financiare për komunën dhe vlerë të dobët për para.

Rekomandimi 18 Kryetari duhet t'i përcaktojë arsyet për nivelin e ulët të adresimit të rekomandimeve dhe të siguroj se janë përgatitur plane të veprimit për adresimin e rekomandimeve, duke përfshirë kohën dhe stafin kyç përgjegjës.

Puna e auditimit të brendshëm duhet të reflektojë planin e bazuar në rrezik dhe fushat me rrezik të lartë dhe aty kontrollet menaxheriale nuk funksionojnë duhet të jenë prioritet i AB. Ndërsa, Komiteti i Auditimit duhet ta monitorojë zbatimin e rekomandimeve, dhe aty ku është e nevojshme, të kërkojë shpjegime për moszbatim.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Rreziqet Sinjifikante – Pasuritë	Rekomandimi 1 –Kryetari i Komunës duhet të identifikojë arsyet si për keq deklarinimin të vlerës së pasurive, ashtu edhe dështimit në adresimin e këshillës së ZAP. Procese adekuate duhet të vihen në funksion në vitin 2014 për të siguruar se paraqitet saktë gjendja e pasurive kapitale dhe jo-kapitale të komunës.			X
PVF	Rekomandimi 2 –Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF të vitit 2014 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat e që kanë të bëjnë me cilësinë e informatave dhe kërkesat specifike të raportimit. Deklarata e ZKA dhe ZKF lidhur me saktësinë e PVF nuk duhet të dorëzohet para se të jenë bërë të gjitha rishikimet e duhura.			X
Adresimi i rekomandimeve nga viti i kaluar	Rekomandimi 3 –Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë një afat kohor konkret dhe sfidues në adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Kryetari i Komunës në baza mujore.		X Sepse plani vetëm formalisht është përgatitur dhe nuk përfshinë stafin kyç përgjegjës, kohën dhe veprimet e nevojshme.	

Qeverisja e mirë	Rekomandimi 4 -Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar përmes së cilës Menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato. Ky proces duhet të mbështetet me dorëzimin e vetëvlerësimit të kërkuar nga MF.		X Qeverisja e mirë nuk është në nivelin e pritur. Edhe më tutje nevojiten përmirësime. Vetëvlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve nuk janë konsideruar.	
Ekzekutimi i buxhetit	Rekomandimi 5 – Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se procesit të përgatitjes së buxhetit i paraprinë një rivlerësim rigoroz i procesit i cili pasqyron në mënyrë të plotë të gjitha informatat relevante, përfshirë lëvizjet e viteve të kaluara apo ndryshimet e pritura nëpër vite.		X Ekzekutim i dobët tek shpenzimet. Dhe mbivlerësim i kërkesave buxhetore	
Të hyrat	Rekomandimi 6 -Kryetari i Komunës duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të faturimit që përfshinë detaje të përditësuara për pagesit. Të ekzistojë lidhje automatike midis sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që të dhënat në librin kryesor të procedohen në mënyrë automatike.			X
Të hyrat	Rekomandimi 7 – Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se zyrtarët e financave/ të hyrave do të hartojnë një bazë të dhënash ku do të identifikohen të gjithë debitorët dhe do të specifikohen qartë shumat e ngarkuara të borxheve të për vitin 2014 si dhe borxhet e prapambetura			X

Të hyrat	Rekomandimi 8 – Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Drejtoria e Urbanizmit të krijojë një bazë të plotë të dhënash për numrin e kërkesave për leje ndërtim; sa janë aprovuar dhe sa janë refuzuar, si dhe të gjitha kërkesat t'i shqyrtoj brenda afateve të përcaktuara. Po ashtu, për çdo shfrytëzues të pronës publike të lidhë kontrata për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike, dhe këto të hyra të regjistrohen sipas planit kontabël.	X		
Shpenzimet me prokurim	Rekomandimi 9 – Kryetari i Komunës duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrollit në klasifikimin adekuat të Kodeve, në mënyrë që pagesat të bëhen vetëm sipas ndarjeve të aprovuara buxhetore.			X
Shpenzimet me prokurim	Rekomandimi 10 Kryetari i komunës duhet ta rishikoj vonesat në projektet e identifikuar nga ZAP dhe të shtojë kontrollet për të siguruar që janë marrë veprime me kohë për adresimin e mangësive.	X		
Shpenzimet me prokurim	Rekomandimi 11 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që fillimisht të zhvillohen procedurat e prokurimit dhe pastaj të bëhen pagesat për kryerjen e shërbimeve duke u bazuar në kontratat valide.	X		
Shpenzimet me prokurim	Rekomandimi 12 –Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë vendosur kontrollet e duhura në procesin e pagesave, në mënyrë që situata të tilla të mos përsëriten.			X
Shpenzimet pa prokurim	Rekomandimi 13 –Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se të gjitha faturat do të paguhën brenda afatit kohor.			X

Kompensimet Paga dhe Mëditje	Rekomandimi 14 –Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se kontratat e reja për mësimdhënie aprovohen vetëm nëse ka buxhet të mjaftueshëm dhe pozita të lira, si dhe pagat të ekzekutohen sipas kontratave të nënshkruara.			X
Kompensimet Paga dhe Mëditje	Rekomandimi 15 –Kryetari i Komunës duhet të përcaktojë pse mangësitë e identifikuara kanë ndodhur, të ndërmerr veprime për t'i adresuar këto dhe të sigurojë se të gjitha rekrutimet e ardhshme bëhen në pajtim me ligjin dhe pasqyrojnë rezultatet e një procesi formal dhe korrekt të vlerësimit.	X		
Kompensimet Paga dhe Mëditje	Rekomandimi 16 –Kryetari i Komunës të siguroj mbajtjen e evidencave të mjaftueshme për numrin e orëve të realizuara për secilin mësimdhënës për të parandaluar ndikimet negative në buxhetin e komunës.	X		
Pasuritë	Rekomandimi 17 –Kryetari i Komunës duhet të merr masa që të hartoj një regjistër gjithëpërfshirës, të plotë dhe të saktë të pasurisë, të aplikojë procedura dhe kontrolle të duhura në identifikimin e të gjitha pasurive si dhe të njëjtat t'i regjistroj sipas rregullores Nr. 02/2013.		X Regjistër i pa plotë i pasurisë. Pasuritë nën 1,000 nuk regjistrohen në modulën E-pasuria.	
Pasuritë	Rekomandimi 18 –Kryetari i Komunës duhet të siguroj që komisionet përkatëse të përgatisin raportet për vlerësim dhe inventarizim. Raportet e komisioneve duhet të shqyrtohen nga Menaxhmenti, dhe pasuritë jo-funksionale të hidhen jashtë përdorimit, ndërsa barazimi i gjendjes së regjistrimeve duhet të reflektohet edhe në regjistrat final të pasurisë.	X		

Trajtimi i të arkëtueshmeve	Rekomandimi 19 –Kryetari i Komunës duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative sipas nevojës.			X
Auditimit i brendshëm	Rekomandimi 20 –Kryetari duhet të bëjë plan veprimi ku përcakton se si do të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga NjAB, të diskutohen dhe adresohen nga të gjitha nivelet e menaxhimit.		X Planet nuk përfshin stafin kyç, kohën dhe veprimet e nevojshme. Adresimi mbetet i ulët	
Gjithsejtë	20 Rekomandime	6	5	9

Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it

Te gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e ZAP-it
Çështja 4 - Mangësi dhe keq prezantim i informatave në PVF – Prioritet i lartë Buxheti final neni 13 tek pjesa e daljes së parasë së gatshme ishte prezantuar gabimisht për 59,394€. Ishte prezantuar 12,508,000€ ndërsa duhet të jetë 12,448,606€. Këto gabime reflektohen edhe në nenin 18 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale.	Jo	Shpërputhja në mes të shumës së prezantuar nga komuna 12,508,000€ dhe asaj që aludohet të jetë nga ana juaj në shumën 12,448,000€ ka të bëjë me diferencën prej 59,394€ shumë kjo e alokuar në vitin 2015 si e hyrë e vitit 2014 por e pa regjistruar nga ana e Ministrisë së Financave, për të cilën kemi bërë vërejtje me kohë në MF por nuk kanë bërë përmirësimin dhe as nuk na kanë njoftuar.	Kjo duket më shumë si një arsyetim nga komuna sepse çdo organizatë buxhetore është e obliguar të menaxhoj me buxhetin e vet dhe t'i përcjellë ndryshimet të cilat ndodhin. E gjetura dhe rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.